



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2021:054518  
Datë: 05.08.2024  
Numri i dokumentit: 06019614

**P.nr.119/2021**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Dega në Viti**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Fatmire Sermaxhaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit S.F..., për shkak se ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.299/2021 të datës 25.02.2021, dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor PP.II.nr.299/2021 të datës 25.02.2021, më datë 05.08.2024, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit S.F..., nga babai F..., i lindur më dt..., në fshatin R... K.V..., me nr. personal NP..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **Është fajtor**

Sepse më datë 04.09.2020, në kohë të pavërtetuar, në fshatin R... , i pandehuri në cilësi të shfrytëzuesit në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energji elektrike, në atë mënyrë që derisa për shkak të mos pagesës së borxhit është ç'kyçur nga rrjeti elektrik, me rastin e kontrollimit punëtorët e autorizuar të KEDS-it, kanë konstatuar se i pandehuri ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik, dhe në këtë mënyrë ka siguruar shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, ashtu që si pasojë e këtyre veprimeve, është pa mundësuar regjistrimi i shpenzimeve të energjisë elektrike, dhe për pasojë tani të dëmtuarës KEDS-it – Distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 192.01€.

-me çka ka kryer veprën penale, vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës së lartë cekur ligjore dhe neneve 4, 38, 43, 69, 70, 71, 72 të KPRK-s, si dhe nenit 493 dhe 495 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton

### **DËNIM ME GJOBË**

**I.** Të pandehurit **S.F...** , i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej **300 (njëqind) euro**, të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

**II.** Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

**III.** Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

**IV.** Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit S.F... nga fshati R.. K. V..., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 par. 1 të KPRK-ës. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e urdhërit ndëshkimorë, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për lëshimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimorë ndaj të pandehurit S.F..., dhe të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor.

Gjendja faktike vërtetohet nga provat materiale siç janë : procesverbali i KEDS-it nr. 2350291 të dt.04.09.2020, fatura nga Sektori i Rikthimit të Humbjeve të dt. 01.09.2020, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes dhe fatura DGLHP209088 të dt. 01.09.2020.

Gjyqtari konstatoi se i pandehuri S.F... nga fshati Ramnishtë K. Vitisë, ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve , nga neni 314 par 1 të KPRK-s në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPRK-s.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP, kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP. Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP-s, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN DEGA NË VITI**

**P.nr.199/2021, Më 05.08.2024.**

**Sekretarja juridike,  
Fatmire Sermahaj**

**Gjyqtari,  
Behar Ymeri**

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtë.

Numri i lëndës: 2021:054518  
Datë: 05.08.2024  
Numri i dokumentit: 06019614